


UDHËRRËFYESI

BASHKËPUNIMI
SHQIPËRI - KOSOVË
NË SEKTORIN E ARSIMIT



Tiranë & Prishtinë, 2019

UDHËRRËFYESI

BASHKËPUNIMI
SHQIPËRI - KOSOVË
NË SEKTORIN E ARSIMIT

Për hartimin e udhërrëfyesit punuan:

Grupi i studiuesve nga Shqipëria:

Prof. Asc. Dr. Pëllumb KARAMETA

Prof. Dr. Anila PAPARISTO

Doktorant Arjan SHAHINI

Dr. Besnik RAMA

Grupi i studiuesve nga Kosova:

Dr. Dukagjin PUPOVCI

Kushtrim BAJRAMI

Design: **envinion**



Udhërrëfyesi *Bashkëpunimi Shqipëri – Kosovë në sektorin e arsimit*, është pjesë e projektit “Shqipëri – Kosovë, Dekonstruktimi i idesë së bashkimit – Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin mes dy vendeve”. Ky projekt është iniciuar dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – OSFA.

Gjetjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë udhëzues janë të autorëve dhe të kontribuuesve institucionalë. Si të tilla, ato nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Shqipërisë për Shoqëri të Hapur dhe të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur.

© 2019 “Qendra Shqiptare e Asistencës Arsimore” (QShAA) & “Qendra për Arsim e Kosovës” (KEC)

Përmbajtja

1. HYRJE	6
2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË UDHËRRËFYESIT	9
3. PËRMBLEDHJE E MARRËVESHJEVE NDËRSHTETËRORE TË BASHKËPUNIMIT	11
4. ZBATIMI I MARRËVESHJEVE NDËRSHTETËRORE	16
4.1. Bashkëpunimi për unifikimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar.....	16
4.2. Bashkëpunimi për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar	17
4.3. Bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.....	17
5. PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E BASHKËPUNIMIT	21
5.1. Propozimet në nivelin e arsimit parauniversitar	22
5.2. Propozimet në nivelin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.....	24
6. PLANI I MUNDSHËM I AKTIVITETEVE PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E ARSIMIT	26
6.1. Arsimi parauniversitar.....	26
6.2. Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor.....	29

1. Hyrje

Rrethanat historike kanë ndikuar që sistemet arsimore në Shqipëri dhe në Kosovë të zhvillohen ndaras njëri-tjetrit. Ndërkohë, bashkëpunimi në sektorin e arsimit ka qenë i kohëpaskohshëm dhe i ndikuar nga faktorë politikë.

Lidhjet e para në arsim u krijuan në vitin 1941, kur qindra mësues nga Shqipëria shkuan në Kosovë për të organizuar procesin mësimor në shkollat shqipe të sapohapura. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ka pasuar një ndërprerje e gjatë e komunikimit, e cila vazhdoi deri në vitin 1968 kur filloi bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Tiranës që rezultoi me shkëmbime të shumta të stafit akademik dhe kërkimor, nga të dyja anët e kufirit. Ky bashkëpunim vazhdoi deri në vitin 1981 kur në Kosovë shpërthyen protestat studentore me kërkesa të qarta për avancimin e statusit politik të krahinës së atëhershme. Më pas, pasoi një dekadë e ndërprerjes së plotë të komunikimit Kosovë-Shqipëri, sepse autoritetet jugosllave të atëhershme e vlerësuan bashkëpunimin si faktor që ndikonte në krijimin e ndjenjave nacionaliste dhe irredentiste të shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Në vitin 1992 filloi faza tjetër e bashkëpunimit. Shqipëria zgjodhi rrugën europiane të zhvillimit, ndërsa Kosova krijoi sistemin paralel të arsimit, për t'i mbijetuar dhunës serbe. Përkundër shtypjes së egër shtetërore që ushtrohej në Kosovë, në periudhën 1992-1999 u publikuan dhjetëra tekste shkollore të përbashkëta, u punua në harmonizimin e programeve mësimore, si dhe u rivendos bashkëpunimi akademik në sektorin e arsimit të lartë. Prej qershorit të vitit 1999, kur trupat e NATO-s hynë në Kosovë dhe përfundoi lufta me Serbinë, bashkëpunimi mes institucioneve arsimore të Kosovës dhe të Shqipërisë zhvillohet në mënyrë normale, pa formalizëm të tepruar, por edhe pa pritshmëri të larta.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, janë nënshkruar katër marrëveshje dhe një protokoll bashkëpunimi ndërshtetëror në fushën e arsimit parauniversitar dhe të lartë:

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, e nënshkruar më 8 mars 2010.
- Marrëveshja e bashkëpunimit për unifikimin e kurrikulës së sistemit arsimor parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, e nënshkruar më 3 qershor 2014.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për bashkërendimin institucional për përparimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar, e nënshkruar më 23 mars 2015.
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, e nënshkruar më 23 mars 2015.
- Protokoll i bashkëpunimit shkencor-teknologjik ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Republikës së Shqipërisë, i nënshkruar më 7 maj 2019.

Edhe pse mungojnë të dhëna të sakta për përmasat dhe rezultatet e bashkëpunimit në sektorin e arsimit, ekziston bindja se mundësitë për bashkëpunim nuk shfrytëzohen në masën e duhur. Për të hulumtuar më mirë nivelin e këtij bashkëpunimi, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur, në Shqipëri dhe në Kosovë, kanë mbështetur projektin “Përmirësimi i bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë në sektorin e arsimit”, i cili zbatohet nga dy organizata me kontribute në arsim: Qendra Shqiptare e Asistencës Arsimore (QShAA) në Tiranë dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në Prishtinë. Përmes tij synohet të

analizohet bashkëpunimi Shqipëri - Kosovës në arsim në 10 vitet e fundit, si dhe të identifikohen mundësitë për ta përmirësuar më tej atë.

Projekti po realizohet i ndarë në katër faza, në periudhën qershor 2019 – shkurt 2020.

Në fazën e parë (qershor – gusht 2019), përmes analizës së burimeve ekzistuese, intervistave dhe/ose anketave me persona përgjegjës në arsim, u mblodhën të dhëna dhe u siguroa informacion mbi zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në sektorin e arsimit. Njëherazi, u mblodhën të dhëna për bashkëpunimin në periudhën 2010-2018, që ndihmuan për identifikimin e çështjeve që përcaktohen ose jo në marrëveshjet dypalëshe dhe që kanë potencial për të prodhuar efekte të njëpasnjëshme. Rezultatet u pasqyruan në **Raportin paraprak** të hartuar nga studiuesit e përfshirë në këtë projekt, pas diskutimeve me pjesëmarrësit në tryeza të diskutimit të cilët kontribuan për identifikimin e fushave dhe formave të reja të bashkëpunimit në të ardhmen.

Në fazën e dytë (shtator - tetor 2019), bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e Raportit, u organizuan veçmas tryeza diskutimi, në Tiranë dhe në Prishtinë, si dhe një tryezë e përbashkët, me pjesëmarrës nga të dy vendet. Në këtë mënyrë nga palët me interes në Shqipëri dhe në Kosovë u siguruan propozime për fushat dhe format e bashkëpunimit, të cilat janë reflektuar në dokumentin me titull “**Propozime për përmirësimin e bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë në arsim**”.

Në fazën e tretë (nëntor – dhjetor 2019), mbi bazën e Raportit dhe të propozimeve të ofruara nga kontribuuesit në projekt, është hartuar ky **Udhërrëfyes**, ku përshkruhen gjendja / problematikat dhe jepen rekomandime specifike, afatshkurtra dhe afatmesme, që mund të ndihmojnë përmirësimin e bashkëpunimit në sektorin e arsimit.

Në fazën e katërt (janar – shkurt 2020), publikimi i Udhërrëfyesit, do të shoqërohet me debate të drejtpërdrejta ose panele të ekspertëve për tematika të ndryshme. Në këto diskutime, krahas ekspertëve të QSHAA dhe KEC, do të ftohen përfaqësues të institucioneve arsimore shtetërore, akademike dhe organizata jo-qeveritare të angazhuara në fushën e arsimit.

2. Qëllimi dhe metodologjia e hartimit të udhërrëfyesit

Qëllimi

Të analizohet bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit, gjatë 10 viteve të fundit dhe të shqyrtohen mundësitë për ta përmirësuar këtë bashkëpunim.

Pyetjet e hulumtimit

- Në çfarë masë janë shfrytëzuar mundësitë e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë në fushën e arsimit në 10 vitet e fundit?
- Si mund të përmirësohet ky bashkëpunim në të ardhmen?

Metodologjia

Hulumtimi, i cili siguroi të dhënat e prezantuara në Udhërrëfyes, është realizuar përmes qasjes kërkimore cilësore. Faza e parë e këtij hulumtimi përfshiu analizën e marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërshtetëror mes Shqipërisë dhe Kosovës. Krahas marrëveshjeve ndërshtetërore janë siguruar dhe analizuar marrëveshjet ndërinstitucionale të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë publik në Shqipëri dhe në Kosovë.

Për secilën marrëveshje ndërshtetërore janë identifikuar dhe shqyrtuar aspektet kryesore të bashkëpunimit. Analiza mundësoi përgatitjen e strukturës së intervistave individuale dhe të anketave që u zhvilluan me zyrtarë të ministrive përgjegjëse për arsimin në të dyja vendet, me përfaqësues të agjencive të specializuara si dhe me përfaqësues të institucioneve publike të arsimit të lartë.

Përmes intervistave / anketave individuale janë grumbulluar të dhëna për nivelet e zbatimit të marrëveshjeve dhe janë identifikuar mundësitë për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në fushën e arsimit. Propozimet e diskutuara me grupet e interesit dhe me ekspertët në të dyja vendet paraqiten në Udhërrëfyes si një plan me propozime konkrete që mund të shërbejnë për përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, në të dyja vendet. Plani është strukturuar në tri shtylla ku pasqyrohen objektivat, rezultatet për secilin prej objektivave, si dhe aktivitetet për arritjen e tyre.

3. Përmbledhje e marrëveshjeve ndërshtetërore të bashkëpunimit



Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe të shkencës (2010)

Marrëveshja, e nënshkruar më 8 mars 2010, është e para në fushën e arsimit, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kjo marrëveshje ka karakter të përgjithshëm dhe synon të forcojë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, në fushën e arsimit dhe të shkencës, nga nivelet e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë deri te bashkëpunimi në fushën e kërkimeve shkencore. Me anë të saj, të dyja palët u zotuan për shkëmbimin e vijueshëm të informacioneve mbi organizimin e institucioneve arsimore dhe të kërkimeve shkencore, si dhe për vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet strukturave në nivelin e ministrive përkatëse për arsimin dhe shkencën, në nivelin e arsimit parauniversitar, të arsimit të lartë dhe të institucioneve shkencore. Gjithashtu, të dyja palët shprehin zotimin për të mbështetur pjesëmarrjen e mësuesve, ekspertëve dhe kërkuesve shkencorë në seminare, simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare, për bashkëpunimin aktiv në kuadrin e programeve ndërkombëtare për arsimin dhe shkencën, në realizimin e

projekteve të përbashkëta shkencore dhe hulumtuese, në programe të shkëmbimit dhe mobilitetit të studentëve, në ofrimin e bursave për studime universitare, në shkëmbimin e praktikave dhe ekspertëve në fushën e akreditimit në arsimin e lartë, në lehtësimin e procedurave për njohjen e ndërsjellë të certifikatave, diplomave, titujve dhe të gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet arsimore të dy vendeve.

Në fushën e arsimit parauniversitar, palët zotohen të bashkëpunojnë për shkëmbimin e kurrikulave dhe të përvojave për të siguruar tekste shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm, si dhe për të nxitur binjakëzimin e shkollave për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe arsimore. Marrëveshja është lidhur për një afat pesëvjeçar, me mundësinë e përtëritjes në mënyrë automatike edhe për një periudhë pasuese pesëvjeçare.



Marrëveshja për unifikimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës (2014)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) e Republikës së Shqipërisë^[1], në vitin 2014, nënshkruan marrëveshjen që të mbështesin unifikimin e kornizave kurrikulare të arsimit parauniversitar të dy vendeve. Me anë të marrëveshjes, të dyja palët shprehën zotimin e tyre për të krijuar të gjitha mundësitë për vendosjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet strukturave përkatëse në nivel të ministrive dhe të strukturave/agjencive në fushën e hartimit të kurrikulave, përmes grupeve të përbashkëta me ekspertë të fushës, me qëllim hartimin e dokumenteve kurrikulare të unifikuara, sipas përvojave ndërkombëtare, si dhe vlerësimin periodik të zbatimit të reformës kurrikulare në arsimin parauniversitar të dy vendeve. Palët zotohen të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën për vendimet që ndërlidhen me ndryshimin e dokumenteve kurrikulare në arsimin parauniversitar. Marrëveshja synon vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta midis strukturave përkatëse në nivelin e ministrive dhe agjencive/strukturave, si dhe ngritjen e grupeve të punës që do të takohen për të mundësuar zbatimin e marrëveshjes.

¹ Në vitin 2017, Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë (MAS) është emërtuar "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë" (MASR).



Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MAS dhe MASHT për përparimin dhe zhvillimin e vazhduar profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar (2015)

Në zbatim të marrëveshjes për unifikimin e kurrikulave të arsimit parauniversitar të dy vendeve, MAS dhe MASHT, në kuadër të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, të mbajtur më 23 mars 2015 në Tiranë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për bashkërendim institucional të formimit fillestar dhe zhvillimit profesional të mësuesve^[2] në arsimin parauniversitar, përmes fuqizimit të bashkëpunimit institucional për zhvillim profesional të drejtuesve të shkollave dhe shërbimit profesional në arsimin parauniversitar për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca, përmes hartimit të materialeve të përbashkëta për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe shkëmbimit të përvojave dhe organizimit të takimeve të përbashkëta ndërmjet institucioneve të dy vendeve për çështje që ndërlidhen me kurrikulën dhe trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar.

Për më shumë, marrëveshja parasheh krijimin e moduleve dhe skemave të përbashkëta të trajnimit mbi kurrikulën, hartimin e standardeve profesionale për formimin fillestar dhe të vazhdueshëm të mësuesve, lidhur me zbatimin e kurrikulës së re të arsimit parauniversitar. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, të dyja vendet përcaktuan institucionet përkatëse, rrjedhimisht, Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA)^[3] në Shqipëri dhe Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK). Marrëveshja është lidhur për një afat pesëvjeçar me mundësinë e përtëritjes në mënyrë automatike edhe për një periudhë pasuese pesëvjeçare.

2 Këtu e në vijim, termi "mësimdhënës" është zëvendësuar me termin "mësues".

3 Pas vitit 2019, Instituti i Zhvillimit të Arsimit është pjesë e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin parauniversitar (ASCAP).



Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet
Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës
së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës
së Kosovës në fushën e arsimit të lartë dhe
kërkimit shkencor (2015)

Një marrëveshje tjetër ndërmjet MAS dhe MASHT, e nënshkruar në kuadër të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive të mbajtur më 23 mars 2015 në Tiranë, është ajo e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. Kjo marrëveshje ka afat trevjeçar, me mundësinë e përtëritjes në mënyrë automatike edhe për një periudhë pasuese trevjeçare. Kuadri i veprimit të marrëveshjes prek kryesisht çështje ligjore, të kërkimit shkencor, të shkëmbimit dhe mobiliteteve, të planprogrameve të arsimit të lartë, të infrastrukturës kërkimore/mësimore dhe të kualifikimit.

- Në fushën e legjislacionit, palët zotohen për harmonizimin e legjislacionit në fushën e arsimit dhe të kërkimit shkencor.
- Në fushën e kërkimit shkencor synohet të bashkëpunohet: (a) në partneritetet në projektet rajonale dhe ndërkombëtare të kërkimit, si p.sh., aplikime të përbashkëta në programet e Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion “Horizon 2020”; (b) në shkëmbimin e informacionit, publikimin e dokumenteve shkencore dhe shpalljen e rezultateve të hulumtimeve shkencore për të dyja shtetet; (c) në shkëmbimin e hulumtuesve të fokusuar në fusha të ndryshme shkencore, përfshirë këtu shkencat e natyrës, teknike, bioteknike, mjekësore dhe shkencat shoqërore; (d) në organizimin e konferencave dhe seminareve të përbashkëta; (dh) në projekte të përbashkëta në fushën e inovacionit dhe transferit të teknologjisë.
- Në fushën e mobiliteteve synohet të shtohet shkëmbimi i stafëve akademike dhe administrative.
- Në fushën e programeve të studimit synohen: (a) programe të përbashkëta studimi në cikle të ndryshme, veçanërisht të programeve të doktoratës dhe (b) shkëmbimi i literaturës, planeve mësimore dhe programeve të studimit.

- Bashkëpunimi në fushën e infrastrukturës kërkimore e mësimore ka për qëllim hartimin e politikave të përdorimit të përbashkët të objekteve dhe pajisjeve shkencore dhe teknike.
- Për çështje të kualifikimeve marrëveshja synon:
 - (a) lehtësimin e procedurave për njohjen e diplomave, titujve dhe gradave, të lëshuara në institucionet e arsimit të lartë në të dyja shtetet;
 - (b) ofrimin e asistencës teknike për Republikën e Kosovës në fushën e profesioneve të rregulluara.



Protokoll i Bashkëpunimit shkencor-teknologjik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës (2019)

Protokoll i lidhur ndërmjet MASHT dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor në Shqipëri, promovon bashkëpunimin e dyanshëm dhe rajonal në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Qëllimi i marrëveshjes është financimi i 10 projekteve të përbashkëta kërkimore për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kërkimore-shkencore dhe komuniteteve shkencore të dy vendeve. Thirrja është e hapur për të gjitha disiplinat shkencore dhe fushat. Projektet do të mbështeten për një periudhë dyvjeçare. Vlerësimi i aplikimeve parashihet të realizohet në mënyrë të pavarur nga secili vend, nga ekspertët e fushave përkatëse. Në përfundim të vlerësimit të ndarë, Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik do të përzgjedhë 10 projekte fituese. Çdo projekt fitues do të mbështetet në shumën maksimale 3000 EUR në vit, e cila ka për qëllim të mbulojë shpenzimet e përgjithshme që ndërliidhen me natyrën ndërkombëtare të projekteve, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet ditore. Thirrja është hapur në datën 15 maj 2019 dhe është mbyllur më 15 gusht 2019. Projekt-propozimet fituese do të financohen për një afat kohor dyvjeçar, me grante të ndara për secilin vit.

4. Zbatimi i marrëveshjeve ndërshtetërore

4.1 Bashkëpunimi për unifikimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar

Kosova në vitin 2011, miratoi Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të bazuar në kompetenca, e cila paraqet një zhvendosje domethënëse nga kurrikula tradicionale e bazuar në përmbajtje. Kjo kërkon ndryshime të thella, që prekin të gjithë sistemin arsimor: dokumentacionin kurrikular dhe procesin e të nxënit, reformimin e sistemeve të formimit fillestar, të kualifikimit dhe të zhvillimit profesional të mësuesve, deri tek infrastruktura fizike e institucioneve arsimore.

Modeli i qasjes së re kurrikulare të Kosovës u ndoq edhe nga Shqipëria. Kjo e fundit ka miratuar Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, e cila i ka të njëjta me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë, synimet, parimet, kompetencat, shkallët dhe nivelet arsimore, si dhe fushat e të nxënit. Po ashtu, janë hartuar kurrikulat bërthamë për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Shqipëri, të cilat kanë afërsisht të njëjtat rezultate të të nxënit, si të kurrikulave bërthamë në Kosovë.

Dy vendet kanë përafruar dokumentin e standardeve të teksteve shkollore për arsimin parauniversitar, ku ofrohen kritere të përbashkëta për vlerësimin dhe certifikimin e teksteve shkollore si dhe ka pasur bashkëpunime të kohëpaskohshme në procesin e konkurrimit, përzgjedhjes, vlerësimit dhe pilotimit të teksteve shkollore të reja. Në kuadër të bashkëpunimit për unifikimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar, janë organizuar takime dhe tryeza të përbashkëta pune mes dy palëve ku janë ndarë përvoja pozitive, si dhe janë hartuar produkte kurrikulare.

4.2 Bashkëpunimi për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar

Shqipëria dhe Kosova kanë krijuar grupin e përbashkët për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar, i cili ka realizuar disa takime në Shqipëri dhe në Kosovë për shkëmbimin e informacioneve në këtë fushë. Gjatë takimeve janë shkëmbyer skemat e trajnimeve përkatëse si dhe materialet përkatëse. IZHA në Shqipëri ka hartuar paketën e plotë të moduleve të trajnimit për kurrikulën me kompetenca dhe e ka diskutuar atë me kolegët nga Kosova. Po ashtu, IZHA ka bashkëpunuar me MASHT, veçanërisht për dokumentet e kurrikulës, vlerësimin e nxënësit, procesin e hartimit dhe të përzgjedhjes së teksteve shkollore të reja të bazuara në kurrikulën me kompetenca. Megjithatë, dy vendet ende nuk kanë arritur të përmbushin zotimet për krijimin e skemave/moduleve të përbashkëta të trajnimit dhe, për këtë qëllim, nuk ka buxhet të planifikuar.

4.3 Bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

Bashkëpunimi në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor është formalizuar përmes disa marrëveshjeve të nënshkruara nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat janë marrëveshje kornizë dhe të përgjithshme dhe që pothuajse promovojnë të njëjtat qëllime:

- Shkëmbimin e përvojave dhe informacionit mbi programet e studimit, metodave dhe procedurave didaktike.
- Shkëmbimin e personelit akademik dhe administrativ si dhe të studentëve.
- Organizimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor.
- Promovimin dhe shkëmbimin e aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore.
- Bashkëpunimin në shkëmbimin e librave, revistave dhe materialeve të tjera edukative.
- Organizimin dhe pjesëmarrjen në takime dhe seminare shkencore dhe profesionale, konferenca, simpoziume dhe forma të tjera të arsimit.
- Botimin e përbashkët të teksteve universitare.

Bazuar në të dhënat e mbledhura përmes intervistave të realizuara me zyrtarë të MASR-së dhe MASHT-it, si dhe përfaqësues të institucioneve publike të arsimit të lartë në Shqipëri dhe në Kosovë, mund të kuptohet që nuk ka bashkëpunim të ngushtë dhe thelbësor mes institucioneve të arsimit të lartë të të dy vendeve.

Në çështjet e kualifikimit dhe të njohjes së kredencialeve vlerësohet se procedurat e njohjes së diplomave ndërmjet dy vendeve janë lehtësuar. Për lehtësimin e procedurave ka pasur disa takime zyrtare midis përfaqësuesve të qeverive të dy vendeve në nivel ministrash dhe zëvendësministrash. Zyrtarët e dy ministrive përgjegjëse për arsimin vlerësojnë se ky proces, i cili realizohet ndërmjet strukturave përkatëse të dy vendeve (zyrave të ENIC/NARIC), është lehtësuar tashmë edhe përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit (p.sh., faza e verifikimit të autenticitetit të diplomave).

Në fushën e sigurimit të jashtëm të cilësisë (akreditimit) ende nuk ka marrëveshje zyrtare bashkëpunimi mes dy agjencive të sigurimit të cilësisë. Në baza personale, janë angazhuar, së fundmi, disa ekspertë nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë në procesin e akreditimit të programeve të studimit të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri. Të dyja agjencitë janë anëtare të rrjetit të agjencive ballkanike të sigurimit të cilësisë.

Në fushën e hartimit të politikave vërehet se marrëveshjet ndërshtetërore nuk reflektohen në planet e punës të ministrive dhe institucioneve që janë të ngarkuara për zbatim dhe në strategjitë afatgjate të sektorit të arsimit dhe shkencës. Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022 e Shqipërisë iu referohet marrëveshjeve ndërshtetërore me Kosovën në një paragraf kushtuar bashkëpunimit rajonal, prej nga jepet përshtypja se bashkëpunimi me Kosovën vështrohet në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, pa gëzuar një status të veçantë. Në synimet strategjike nuk ka një objektiv dhe aktivitete të veçanta në lidhje me bashkëpunimin me Kosovën, sikur parashihen për tërheqjen e studiuesve nga diaspora. Ndërsa në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA 2019-2021/Shqipëri) nuk ka asnjë zë për financimin e aktiviteteve në kuadër të marrëveshjeve me Kosovën, as edhe tregues të vlerësimit të performancës në nivel ministrie. Situatë e ngjashme paraqitet edhe në kuadrin e politikave strategjike të MASHT-it.

Nga informacionet e ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, kuptohet që nuk zbatohet asnjë program i përbashkët i studimit ndërmjet të dy vendeve. Ka pasur një iniciativë për organizimin e një programi të përbashkët të shkëmbimit akademik ndërmjet Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës në fushën e elektroenergjetikës,

meqenëse Kosova ka mungesë të kuadrove në këtë fushë, por edhe kjo është në fazë fillestare. Ka pjesëmarrje të personelit akademik nga të dy vendet në komisione për mbrojtje të doktoratave, por ky bashkëpunim nuk është i institucionalizuar.

Në fushën e kërkimit shkencor, të dy vendet kanë shpallur për herë të parë thirrjen për projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor Shqipëri-Kosovë, e cila ishte hapur në 15 maj deri më 15 gusht 2019, ku planifikohet të mbështeten 10 projekte të tilla.

Në fushën e partneriteteve të përbashkëta për aplikim në programet ndërkombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, të dy vendet nuk kanë asnjë projekt të përbashkët në programin e BE-së për Kërkim dhe Inovacion “Horizon 2020”. Ndërkohë, ka projekte multilaterale ku marrin pjesë institucione nga Kosova dhe Shqipëria.

Në fushën e mobilitetit të studentëve, stafit akademik dhe hulumtueseve shkencorë ndërmjet dy vendeve, mungojnë të dhënat dhe monitorimi. As institucionet e arsimit të lartë dhe as ministrinë përgjegjëse për arsimin në të dyja vendet nuk disponojnë të dhëna për mobilitetin e studentëve, të stafit akademik dhe të hulumtuesve të dy vendeve. Kuotat e ndërsjella për pranimin e studentëve në institucionet e arsimit të lartë përfshijnë edhe kandidatët nga të dyja vendet. Sipas statistikave të arsimit, numri i përgjithshëm i studentëve nga Shqipëria që ndjekin studimet në nivelet bachelor dhe master, në vitin akademik 2018/2019, në universitetet publike dhe kolegjet private në Kosovë, është 245. Ndërsa, numri i përgjithshëm i stafit akademik nga Shqipëria që ligjërojnë në universitetet publike në Kosovë, në vitin 2018/2019, është 25 profesorë / asistentë^[4].

Nga intervistat me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në të dyja vendet, mund të kuptohet se kontaktet për mobilitetin e stafit akademik janë ndërtuar kryesisht mbi baza personale dhe nuk janë të formalizuara. Institucionet shprehen se nuk kanë buxhete të parapara për mobilitetin e stafit akademik. Midis njësive akademike të institucioneve të arsimit të lartë të të dy vendeve, në kuadër të njohjeve personale, janë realizuar këmbime edhe në nivel të konferencave të përbashkëta. Në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Pejës rastet më të shpeshta të bashkëpunimit në angazhimin e profesorëve me kohë të pjesshme nga Shqipëria janë në fushën e bujqësisë dhe shumica e këtyre aktiviteteve dhe shkëmbimeve kanë në fokus procesin mësimor dhe jo kërkimin shkencor.

Në nëntor të vitit 2016, Kosova ka miratuar ligjin për profesionet e rregulluara duke ndjekur modelin e legjislacionit të Shqipërisë në përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve

4 MASHT, Statistikat e Arsimit 2018/19. [<https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/statistikat-e-arsimit-2018-2019.pdf>]

për ushtrimin e profesionit të rregulluar, që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit publik. Në këtë drejtim, për të konkretizuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave përkatëse në nivel ministrie për ofrimin e asistencës teknike për Kosovën në fushën e profesioneve të rregulluara, Shqipëria ka ngritur një grup pune për zhvillimin e kësaj përvoje ligjore në të dyja vendet. Ndërkohë, pritet të zyrtarizohet grupi i punës në Kosovë.

5. Propozimet për përmirësimin e bashkëpunimit

Propozimet për bashkëpunimin më efikas të Shqipërisë dhe Kosovës në sektorin e arsimit përfshinë çështje që besohet se do të prodhojnë derivate ndërveprimi dhe përafrimi, për të cilat ekziston vullneti politik dhe kapacitetet institucionale. Këto propozime janë kryesisht produkte të vlerësimit objektiv të arritjeve të deritanishme në kontekstin e bashkëpunimit të të dy vendeve, konkretisht:

- Të analizës së dokumentacionit ekzistues për bashkëpunimin ndërshtetëror dhe ndërinstitucional në sektorin e arsimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave që veprojnë në dy vendet.
- Të intervistave / anketave individuale nga ku janë siguruar të dhëna me vlerë për nivelet e zbatimit të marrëveshjeve dhe për mundësitë që lejojnë të zhvillohet më tej bashkëpunimi në fushën e arsimit.
- Të njohjes së dallimeve dhe të afërsive, traditave pedagogjike, nevojave dhe mundësisive të secilit sistem arsimor.
- Të trendëve dhe risive arsimore bashkëkohore në Evropë dhe më gjerë.
- Të konsensusit profesional të artikuluar pas aktiviteteve konceptuese, analizuese e zhvilluese dhe diskutimeve e debateve të hapura në punëtorinë dhe takimet e organizuara në Prishtinë dhe në Tiranë për përmirësimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

5.1 Propozimet në nivelin e arsimit parauniversitar

Shqipëria dhe Kosova tanimë kanë kornizë kurrikulare të unifikuar për arsimin parauniversitar, e cila është e bazuar në kompetenca dhe në rezultatet e të nxënësve, për dallim nga kurrikulat e mëhershme që ishin të bazuara në objektiva dhe përmbajtje mësimore. Zbatimi i një kurrikule të tillë paraqet sfidë më vete, pasi kërkon më shumë mbështetje profesionale për mësuesit dhe shkollat, vënie në dispozicion të teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore që i përgjigjen kërkesave të kurrikulës së re, si dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të defekteve që paraqiten. Pikërisht në këto tri aspekte të zbatimit të kurrikulës së re – mbështetja profesionale, tekstet e mjetet mësimore dhe monitorimi – shihet potenciali më i madh për bashkëpunim në mes të dy vendeve në fushën e arsimit parauniversitar (Objektivi 1).

Një aspekt tjetër i ndërlidhur është përfarimi i programeve për formimin fillestar, licencimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave (Objektivi 2). Përkundër faktit se Shqipëria dhe Kosova kanë sisteme të ndryshme të arsimit të dy vendet mund të përfitojnë nga përvoja e njëri-tjetrit në këto fusha. Në veçanti, Kosova mund të përfitojë nga përvoja e Shqipërisë në zbatimin e sistemit për certifikimin fillestar të mësuesve të arsimit parauniversitar, pasi akoma nuk ka krijuar struktura për zbatimin e Ligjit për profesionet e rregulluara, ku bën pjesë edhe profesioni i mësuesit.



Objektivi 1:

Të përmirësohet bashkëpunimi për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca.

Hapi i radhës pas unifikimit të kornizës së kurrikulës për arsimin parauniversitar mund të jetë vlerësimi i përbashkët i zbatimit të saj në të dy vendet. Për këtë qëllim, rekomandohet krijimi i ekipit të përbashkët të vlerësimit, i cili do të hartojë metodologjinë dhe instrumentet e vlerësimit, duke filluar me vlerësimin e zbatimit në nivelin e arsimit fillor (klasat 1-5). Të dy vendet tanimë kanë përafuar standardet për tekste shkollore që hap rrugën për hartimin e teksteve të përbashkëta në fushën e gjuhës dhe historisë, gjithnjë

duke respektuar specifikat dhe legjislacionin në fuqi. Përveç kësaj, duhet punuar edhe në hartimin e botimeve të përbashkëta për letërsinë, gjeografinë, antropologjinë kulturore shqiptare, si dhe të materialeve për avancimin e kompetencës së komunikimit, e cila është shpërfaqur si pikë e dobët nga rezultatet e testit PISA.

Të dy vendet tanimë kanë hartuar botime ndihmëse për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për zbatimin e kurrikulës së re dhe besohet se cilësia e këtyre botimeve do të përmirësohet dukshëm sikur ato të ishin rezultat i një bashkëpunimi ndërshtetëror. Prandaj, edhe inkurajohet bashkëpunimi në këtë fushë, me përqendrim në fushën e vlerësimit. Në veçanti, rekomandohet vendosja e një bashkëpunimi të afërt në mes të Qendrës së Shërbimeve Arsimore në Shqipëri dhe Njësisë për Vlerësim dhe Standarde të MASHT në Kosovë në hartimin e pyetjeve për testet kombëtare në arsimin parauniversitar, të cilat, përveç tjerash, ofrojnë informacion për efektet e kurrikulës së re.



Objektivi 2:

Të përafrohen programet e formimit, licencimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore.

Me gjithë faktin se dy vendet kanë sisteme të ndryshme për formimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, ato mund të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi në këtë fushë. E para, duhet punuar në zhvillimin e përfarimit e standardeve për drejtues të shkollës, si dhe në zhvillimin e moduleve online për kualifikimin e drejtuesve që akreditohen nga autoritetet e të dy vendeve. Pastaj, do të duhej përfaruar edhe standardet për formimin fillestar dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësuesve, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e programeve universitare për profilet e mësuesisë dhe programeve të trajnimit në shërbim. Dhe, e treta, mund të punohet në përfarimin e sistemeve për certifikimin fillestar të mësuesve (provimin shtetëror), ku Shqipëria tanimë ka krijuar përvojë, ndërsa Kosova ndodhet në prag të krijimit të strukturës institucionale për zbatimin e Ligjit për profesionet e rregulluara

5.2 Propozimet në nivelin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

Një numër i madh i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë kanë lidhur marrëveshje me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë, me theks të veçantë në shkëmbimin dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. Nxitja e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve do të ndikonte në bartjen e shpejtë dhe të nevojshme të përvojave të mira të institucioneve të arsimit të lartë të të dy vendeve për ngritjen e cilësisë së planeve dhe të programeve të studimit. Në këtë drejtim, krijimi i skemave të mbështetura financiarisht që mundësojnë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve dhe programe të përbashkëta të studimit në arsimin e lartë përbëjnë një mundësi të mirë për bashkëpunim në mes të dy vendeve (Objektivi 3). Një mundësi tjetër për bashkëpunim është financimi i projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe zhvillimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturës kërkimore shkencore (Objektivi 4). Qartazi, sektori kërkimor në vetvete nuk do të ishte përfitues i vetëm i kësaj qasjeje, por edhe fushat e tjera të politikave, si politikat ekonomike, politikat shëndetësore, politikat e mjedisit, politikat bujqësore, planifikimi urban dhe rural dhe fusha të tjera, të gjitha këto do të mund të përfitojnë nga bashkëpunimi i dy vendeve në aktivitete të përbashkët kërkimore-shkencore.



Objektivi 3:

Të krijohet fondi i përbashkët për mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë mes dy vendeve dhe organizimin e programeve të përbashkëta të studimit

Për të ndërtuar skemat që mundësojnë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë rekomandohet arritja e një marrëveshjeje ndërshtetërore për krijimin e fondit të përbashkët për mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë mes dy vendeve. Në kuadër të këtij fondi duhet të krijohen programe specifike që mbështesin mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve. Me qëllim të rritjes së mobilitetit, të dy vendet duhet synojnë mbështetjen e së paku 40 mobiliteteve

të studentëve dhe 40 mobiliteteve të stafit akademik, në baza vjetore, në institucionet e arsimit të lartë të dy vendeve. Përveç kësaj, duhet punuar edhe në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të studimit, duke themeluar fillimisht grupin e përbashkët të punës për zhvillimin e kriterëve dhe fushave për përgatitjen e programeve të përbashkëta të studimit, si dhe duke ndarë fondin për zbatimin e tyre. Duke marrë parasysh që aktualisht nuk zbatohet asnjë program i përbashkët i studimit në arsimin e lartë, të dy vendet duhet të synojnë mbështetjen e së paku një programi të përbashkët të studimit në vit, në radhë të parë në nivelin master ose atë të doktoratës.



Objektivi 4:

Të krijohet fondi i përbashkët për financimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore-shkencore.

Së fundi, në fushën e kërkimit shkencor, të dy vendet kanë shpallur për herë të parë thirrjen për projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor Shqipëri-Kosovë, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet MASHT dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor në Shqipëri. Hapi i radhës mund të jetë krijimi i fondit të përbashkët të kërkimit shkencor mes dy vendeve për financimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor. Të dy vendet duhet synojnë mbështetjen e së paku 10 projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor, në baza vjetore, në institucionet kërkimore të dy vendeve. Projektet mund të përfshijnë pjesëmarrje apo organizim të konferencave ndërkombëtare, hulumtime dhe publikime të përbashkëta të punimeve shkencore, zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore e tjera. Për më shumë, natyra e punës kërkimore-shkencore është multidisiplinare dhe si e tillë krijon një mundësi të mirë për qasje të integruar në kërkimin shkencor, shfrytëzimin e përbashkët të burimeve njerëzore, infrastrukturës dhe të hapësirave laboratorike nga institucione të ndryshme kërkimore të të dy vendeve. Në këtë drejtim, rekomandohet që vendet të angazhohen për krijimin e regjistrimit të përbashkët të hulumtuesve nga të dy vendet.

6. Plani i mundshëm i aktiviteteve për bashkëpunim në fushën e arsimit

Në vijim janë prezantuar aktivitetet e mundshme për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme. Aktivitetet e mëposhtme duhet të zërthehen më tutje në nën-aktivitete dhe po ashtu duhet të përcaktohen afatet kohore dhe buxheti për zbatimin e tyre.

6.1. Arsimi parauniversitar

OBJEKTIVAT	REZULTATET	SI DO TË ARRIHEN?
Objektivi 1: Të përmirësohet zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca	Rezultati 1.1. Vlerësime të përbashkët për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca.	1.1.1. Krijohet ekipi i përbashkët i vlerësimit për zbatimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca 1.1.2. Përgatitet dhe miratohet programi i vlerësimit. 1.1.3. Hartohet dhe miratohet metodologjia dhe instrumentet e vlerësimit. 1.1.4. Realizohet vlerësimi i parë i përbashkët i zbatimit të kurrikulës në klasat 1-5.

OBJEKTIVAT	REZULTATET	SI DO TË ARRIHEN?
<p>Objektivi 1: Të përmirësohet zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca</p>	<p>Rezultati 1.2. Tekste shkollore të përbashkëta për gjuhën shqipe dhe historinë e shqiptarëve. Botime të përbashkëta për letërsinë, gjeografinë, antropologjinë kulturore shqiptare dhe materiale për kompetencën e komunikimit.</p>	<p>1.2.1. Përfarohen kriteret dhe procedurat për miratimin e teksteve shkollore. 1.2.2. MASR dhe MASHT shpallin konkurs të përbashkët për tekste shkollore dhe krijojnë grupe të përziera të recensentëve. Miratimi duhet bërë ndaras, nga të dyja ministrinë. 1.2.3. MASR dhe MASHT zhvillojnë procedura të reja apo i përafrojnë ato ekzistuese për miratimin e materialeve mësimore ndihmëse për përdorim në shkolla: librat për lexim, përmbledhjet e detyrave, fjalorët, burimet elektronike, e tjera.</p>
<p>Rezultati 1.3. Veprimtari kualifikuese dhe botime ndihmëse për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar, si dhe vlerësim i përmirësuar.</p>	<p>Rezultati 1.3. Veprimtari kualifikuese dhe botime ndihmëse për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave për zbatimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar, si dhe vlerësim i përmirësuar.</p>	<p>1.3.1. Krijohet grupi punues për përgatitjen e materialeve ndihmëse për mësuesit dhe ofrohet financimi i duhur. 1.3.2. Hartohen materiale ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së zbatimit të kurrikulës (ASCAP dhe IPK Kosovë). 1.3.3. Hartohen dhe zbatohen module trajnimi të përbashkëta për mësuesit në funksion të përmirësimit të cilësisë së zbatimit të kurrikulës. 1.3.4. Hartohen udhëzues të përbashkët për vlerësimin e nxënësve. 1.3.5. Shkëmbehen përvojat në zbatimin e kurrikulës. 1.3.6. Qendra e Shërbimeve Arsimore në Shqipëri dhe Njësia për Vlerësim dhe Standarde e MASHT në Kosovë hartojnë bankën e pyetjeve për testet kombëtare të arsimit parauniversitar.</p>

OBJEKTIVAT	REZULTATET	SI DO TË ARRIHEN?
<p>Objektivi 2: Të përafrohen programet e formimit, licencimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave.</p>	<p>Rezultati 2.1. Module për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të drejtuesve të institucioneve arsimore.</p>	<p>2.1.1. Zhvillohen / përafrohen standardet e drejtuesit të shkollës.</p> <p>2.1.2. Zhvillohen module online për kualifikimin e drejtuesve të shkollave dhe akreditohen nga autoritetet e të dy vendeve.</p>
	<p>Rezultati 2.2. Korniza rregullatore e përafuar për formimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.</p>	<p>2.2.1. Përfarohen standardet për formimin fillestar dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësuesve.</p> <p>2.2.2. Standardet e reja shfrytëzohen si bazë për hartimin e programeve mësimore për formimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në të dy vendet.</p> <p>2.2.3. Shkëmbehen përvojat për akreditimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të trajnimit</p>
	<p>Rezultati 2.3. Sisteme të përafërta të certifikimit fillestar (provimi shtetëror).</p>	<p>2.3.1. Kosova krijon autoritetin për menaxhimin e provimit shtetëror.</p> <p>2.3.2. QShA ofron ndihmë profesionale në menaxhimin e provimit shtetëror për profilet e mësuesisë.</p>

6.2. Arsimi i lartë dhe kërkimi shkencor

OBJEKTIVAT	REZULTATET	SI DO TË ARRIHEN?
<p>Objektivi 3: Të krijohet fondi i përbashkët për mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë mes dy vendeve dhe organizimin e programeve të përbashkëta të studimit</p>	<p>Rezultati 3.1. Skema të mbështetura financiarisht që mundësojnë mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë mes dy vendeve.</p>	<p>3.1.1. Hartohet marrëveshja ndërshtetërore për krijimin e fondit të përbashkët për mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë mes dy vendeve.</p> <p>3.1.2. Ndahen fondet dhe krijohen programe specifike të mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>3.1.3. Miratohet dhe shpallet thirrja e përbashkët për mbështetjen e mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>3.1.4. Mbështetja e 40 mobiliteteve të studentëve (çdo vit) në institucionet e arsimit të lartë të dy vendeve.</p> <p>3.1.5. Mbështetja e 40 mobiliteteve të stafit akademik (çdo vit) në institucionet e arsimit të lartë të dy vendeve.</p>
	<p>Rezultati 3.2. Programe të përbashkëta studimi dhe diploma të përbashkëta.</p>	<p>3.2.1. Krijohet grupi i përbashkët i punës për zhvillimin e standardeve / kriterëve dhe fushave për përgatitjen e programeve të përbashkëta të studimit.</p> <p>3.2.2. Ndahen fondet për programe të përbashkëta të studimit.</p> <p>3.2.3. Miratohet dhe shpallet thirrja për mbështetjen e programeve të përbashkëta të studimit.</p> <p>3.2.4. Mbështetja e një programi të përbashkët të studimit (çdo vit) në institucionet e arsimit të lartë të dy vendeve.</p>

OBJEKTIVAT	REZULTATET	SI DO TË ARRIHEN?
<p>Objektivi 4: Të krijohet fondi për financimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore.</p>	<p>Rezultati 4.1. Skema të mbështetura financiarisht që mundësojnë projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p>	<p>4.1.1. Krijimi i fondit të përbashkët të kërkimit shkencor mes dy vendeve për financimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p> <p>4.1.2. Ndahen fondet dhe krijohen programe specifike të financimit të projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p> <p>4.1.3. Miratohet dhe shpallet thirrja e përbashkët për mbështetjen e projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p> <p>4.1.4. Mbështetja e 10 projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor (çdo vit) në institucionet kërkimore të dy vendeve. Projektet përfshijnë pjesëmarrje/organizim të konferencave ndërkombëtare, hulumtime dhe publikime të përbashkëta të punimeve shkencore, zhvillim të infrastrukturës kërkimore-shkencore e tjera.</p> <p>4.1.5. Monitorimi i zbatimit të projekteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.</p>
	<p>Rezultati 4.2. Regjistri i përbashkët i hulumtuesve</p>	<p>4.2.1. Marrëveshje ndërministrorë për krijimin e regjistrit të përbashkët të hulumtuesve nga të dy vendet.</p> <p>4.2.2. Ngritja e grupit për krijimin e regjistrit të përbashkët të hulumtuesve.</p> <p>4.2.3. Zhvillimi i bazës së të dhënave të regjistrit të përbashkët të hulumtuesve.</p>

